Kronikë

EMRAT/ Antidroga e Tiranës bastis lokalin në Kashar, 4 të arrestuar! Zbulohen qindra doza kokaine, drogë xhelatinoze, shkopa bejsbolli dhe maska (VIDEO)

Policia e Tiranës ka vënë në pranga 4 persona të cilët shisnin drogë në një lokal në Kashar. Sipas policisë te arrestuarit në bashkëpunim me njëri-tjetrin, shisnin lëndë narkotike në lokalin e Ardit Hajdarit

Foto nga operacioni i policisë

Redaksia
15 Dhjetor, 10:19 | **Përditesimi: 15 Dhjetor, 13:53**

Share

TIRANË- Antidroga e Tiranës ka bastisur një lokal në Kashar ku shitej drogë, kokainë, kabanis, por dhe drogë xhelatinoze e cila ka hyrë së fundmi në tregun shqiptar.

4 persona janë vënë në pranga në flagrancë ndërsa veç dozave të drogës gati për shitje janë gjetur dhe maska, shkopinj bejsbolli, celularë dhe shuma parash të dyshuara të përfituara nga veprimtaritë e paligjshme.

Në mur shinen të sistemuar 5 shkopa bejsbolli, dozat e kokainës dhe të kanabisit ishin sistemuar në kuti të vogla plastike ndërsa pakot xhelatinoze në një çantë të zezë. Në një kuti tjetër ishin vendosur dhe maskat e zeza dhe një tjetër e bardhë.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Emocionuese/ 20 foshnje kanë ardhur në jetë në maternitetin 'Mbretëresha Geraldinë' gjatë orëve të fundit

Në pranga ranë Ardit Hajdari 36-vjeç, Enri Dema 27-vjeç, dhe Çlirim Hyka, 52 vjeç, e Redis Hyka 21 vjeç të gjithë banues në Tiranë.

Lokali ishte në pronësi të Ardit Hajdarit

> *Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, shisnin lëndë narkotike në lokalin e 36-vjeçarit, informoi sot policia.*

Gjatë kontrollit në lokalin e Hajdarit policia kanë gjetur dhe sekuestruar 1 armë zjarri pistoletë, 150 doza kokaine, 60 doza kanabisi me THC të lartë, 1 peshore elektronike, 5 maska, 4 shkopinj bejsbolli, celularë dhe shuma parash të dyshuara të përfituara nga veprimtaritë e paligjshme.

Droga xhelatinoze kishte hyrë në Tiranë nga Anglia. Operacioni u kodua 'Drug Bar'.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Kashar | Tirane | ardit hajdari | enri dema | clirim hyka | redis hyka

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
A është cënuar siguria në burgje pas vrasjes së ndodhur në atë të Peqinit?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

VIDEO/ Bëri të njëjtën shkelje 2 herë brenda 2 ditëve, gjobitet me 60 mijë lekë drejtuesi i 'benz'-it
16 Dhjetor, 14:27

I vunë flakën derës së banesës së një gruaje, kapen 2 autorët në Tiranë! Njëri prej tyre dyshohet se i vendosi tritol lokalit në rrugën 'Sali Butka'
16 Dhjetor, 13:40

Zbardhet ngjarja ku u dogj makina e personazhit të 'Tik-Tok'-ut, Kozak Braçi! Arrestohen 2 autorët! Në kërkim Kleviol Ahmeti, pagoi 1500 euro për krimin
16 Dhjetor, 12:38

E Bukura e Festave nga DigitAlb, me superofertë e program festiv për të gjithë familjen
16 Dhjetor, 11:00

Sot asfaltimi në Unazën Lindore të Tiranës, rrethrrotullimi Shkozë-Farkë e Madhe, i bllokuar deri në orën 22:00! Çfarë duhet të dinë drejtuesit e mjeteve
16 Dhjetor, 08:26

'Balkan Film Market', 150 kineasta e producentë nga Europa mblidhen në Tiranë
15 Dhjetor, 21:15

Lëvizje në Policinë e Shtetit, shefi i komisariatit nr.1 transferohet në Librazhd! Ja kush e zëvendëson! Ndryshime edhe në policinë kufitare (EMRAT)

Sokol Dema

15 Dhjetor, 20:07

Veliaj me krerët e besimeve fetare dhe trupin diplomatik: Tirana po jeton ditët e saj më të mira! Vetëm bashkë mund t'i çojmë gjërat përpara
15 Dhjetor, 14:58



Tiranë/ Atentati në 'Don Bosko', autori në kërkim, 5 mijë € kush jep informacion! Qëlloi drejt mjetit me 3 persona, dyshohet se ngatërroi shënjestër
15 Dhjetor, 14:12

23 vjeçarja nga Tirana u gjet e përdhunuar në Pejë, Zëdhënësi i prokurorisë për Report Tv tregon si ra 'pre' e abuzuesve, po verifikohen kamerat
15 Dhjetor, 13:46



Mashtronin të huajt të investonin në bursa fiktive , pranga 2 administratorëve të Call Center-it në Tiranë! Në hetim 7 punonjësit
15 Dhjetor, 12:07

Abilaliaj i 'shkel syrin' Shehit: Më në fund doli i lirë, kemi alternativë edhe Dajën
15 Dhjetor, 11:13

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje